



- Të Reja ▾ Policia e Shtetit ▾ Shërbime ▾ Baza ligjore ▾ Vendndodhjet e policisë ▾ Video ▾ Programi i transparencës ▾ Kontakt
- Denonco Krimin Kibernetik ▾ Drejtoritë Vendore të Policisë ▾ Policia Kufitare ▾ Policia Rrugore ▾ Donacione
- Rubrika Policimi në Komunitet ▾ Përmbledhja Javore

Lajmet e Fundit:

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Premtuesi”



Lajmet

Operacionet

14/07/2022

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Driving”

Finalizohet operacioni policor i koduar “Driving”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Operacioni, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 6 dhe Forca e Posaçme “Shqiponja”.

Qarkullonte me armë zjarri në automjet të blinduar, vihet në pranga 26-vjeçari.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë, një krehër, municion luftarak, bizhuteri floriri, një shumë parash dhe automjeti i blinduar.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme “Shqiponja”, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative se në Kashar, një shtetas i armatosur po lëvizte me një automjet, kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “Driving”.

Si rezultat i këtij operacioni, u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

– E. D., 26 vjeç, banues në Krujë, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”.

Gjatë kontrollit të automjetit me drejtues shtetasin E. D. dhe pasagjer shtetasin S. R., 59 vjeç, në Kashar, shërbimet e Policisë, gjetën një armë zjarri pistoletë, një krehër dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, së bashku me automjetin e blinduar, që drejtohej nga shtetasi E. D.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit S. R., u gjetën dhe u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, bizhuteri të ndryshme floriri, për të cilat ky shtetas nuk dispononte dokumentacionin përkatës, si dhe një shumë parash. Viojnë veprimet hetimore për përcaktimin e burimit të sendeve me vlerë dhe të shumës së parave.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Tropojë – Ndërtoi pa leje në zonën e mbrojtur, në fshatin Dragobi, vihet në pranga 50-vjeçari

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Explode”, nga Komisariati i Policisë Vorë ▶